



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 22.03.2018,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP të pavarur, Nol Nushi, GP i pavarur, Drilon Pireva, GP i pavarur, Bashkim Beha, GP i pavarur, Genc Sherifi, GP i pavarur, Mimoza Sylejmani, GP i pavarur, Qëndrim Sahiti, GP i pavarur, Adrian Berisha, GP i pavarur, Visare Gashi, GP i pavarur, Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Sokol Havolli (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Migjen Shala (PDK), Uran Ismaili (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Milot Podvorica (LVV), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Fadil Gashi propozoi që pika e nëntë e rendit të ditës *“Pyetje dhe përgjigje”*, të kalojë si pikën e parë e rendit të ditës, për shkak të prezencës së drejtorëve në fillim të mbledhjeve, të cilët do të kenë mundësi të japin përgjigje për pyetjet e shumta që po parashtrohen nga asamblistët.

Migjen Shala kërkoi që në rend dite të futet edhe një pikë: *“Diskutim për sheshin “Adem Jashari”*” dhe në pika të shkurtra e paraqiti arsyetimin për diskutimin e kësaj pike.

Kryesuesi e hodhi në votim propozim që pika *“Pyetje dhe përgjigje”* të jetë pika e dytë e rendit të ditës, si dhe propozimin për pikën *“Diskutim për sheshin “Adem Jashari”*”.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, pika "Pyetje dhe përgjigje" renditet si pikë e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 10 kundër, 2 abstenime, pika e propozuar nga z. Shala "Diskutim për sheshin "Adem Jashari"', futet në rend dite për diskutim.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, propozoi që pikat 3, 4 dhe 5, që janë propozimvendime për këmbimin e pronës së paluajtshme, të shtyhen për një seancë tjetër dhe të jetë seancë e veçantë, ku do t'i diskutojmë rrjedhimisht të gjitha këmbimet e pronave të paluajtshme, në mënyrë që të mos diskriminohen edhe qytetarët e tjerë që janë në pritje për këmbim të pronës së paluajtshme me pronë komunale.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, për propozimin e z. Retkoceri dha sqarime të nevojshme.

Agim Gashi u shpreh i pajtimit që ajo pikë e rendit të ditës të diskutohet në një seancë tjetër, por të mos shtyhen këto të sotmet, sepse edhe ashtu u tha se janë të grumbulluara këto kërkesa, presin kohë të gjatë për miratim, dhe me shtyrje eventuale mendoj se po bëjmë padrejtësi ndaj tyre.

Eman Rrahmani propozoi që pronarëve, të cilëve duhet t'u merret prona për shkak të interesit publik, kompensimi i tokës t'u bëhet me sipërfaqe ndërtimore e jo me pronë komunale.

Sami Boroci propozoi që pikat 3, 4 dhe 5 të mbeten në rend dite për diskutim.

Shefki Gashi tha se këto pika duhet të diskutohen, mirëpo mos të bëjnë diskriminime dhe të jetë universale për të gjithë, çoftë me këmbim me para, çoftë me ndërrim, çoftë me ndërtim, duke pasur parasysh interesin e qytetarëve, por gjithnjë në kuadër të ligjit.

Uran Ismajli theksoi se në këtë proces duket se ka dyshime, andaj do të ishte mirë që të sqarohet ky proces, të sillen edhe informata të tjera shtesë, pastaj të vijmë te vendimi.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, **Dren Kukaj** drejtor i Drejtorisë së Pronës, dha sqarime të nevojshme.

Nol Nushi u shpreh se kjo është një nismë e mirë, por këto këmbime sot duhet kryer, sepse ata pronarë janë duke pritur kaheerë për të ndërtuar dhe ne faktikisht nuk jemi duke humbur, por jemi duke marrë një pronë tjetër, në mënyrë që aty të ndërtohet një kompleks banesor brenda rregullave të planit urbanistik.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin, që pikat 4, 5 dhe 6 të rendit të ditës të shtyhen për diskutim për mbledhje radhës.

Kryesuesi konstatoi se më 7 vota për, 34 kundër dhe 2 abstenime, nuk kaloi propozimi që këto pika të shtyhen për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe konstatoi se më 41 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Pyetje dhe përgjigje;
3. Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së "Kodra e Trimave 1";
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi;
7. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës;
9. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave, për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
10. Diskutim për sheshin "Adem Jashari";
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Sami Boroci bëri vërejte në ekstrakt, duke thënë se në seancën e jashtëzakonshme, ku është trajtuar problematika e ambientit, në emër të grupit, por edhe si asamblist kam kërkuar që Drejtoria e Parqeve të ridizajnohet dhe të quhet Drejtoria e Ambientit dhe Parqeve, me kompetenca më të zgjeruara, me qëllim që të trajtohet problemi i ambientit në nivel institucional si Komunë.

Fiknete Bejta bëri vërejte në transkript, duke thënë se në vend të fjalës "diskurs" është shkruar fjala "kurs", si dhe në vend të fjalës "përditësim" është shkruar "përgjithshëm", andaj kërkoj që këto të përmirësohen.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e ekstraktit të procesverbalit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 41 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Pyetje dhe përgjigje.

Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës:

- Çka do të ndodhë me banesat, të cilat në njëfarë forme janë uzurpuar nga ish-pushtetarët e LDK-së, ku personalisht Dreni dhe Shpendi kanë thënë se këto banesa do të rikthehen dhe Komuna do t'ua rikthejë rasteve sociale, mirëpo, fatkeqësisht, një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më sot?

- Kërkoj nga organet kompetente që të përkujdesen për mirëmbajtjen e shtatoreve të dëshmorëve. Shembulli i fundit është rasti me shtatoren e Zahir Pajazitit, ku ka ndodhur një skandal i madh, duke larguar nga shtatorja flamurin kombëtar dhe duke vendosur flamujt e imponuar të Republikës së Kosovës.

Eman Rrahmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit:

- Pse nuk ka përfunduar realizimi i projekteve për ndërtimin e çerdheve në lagjet "Kodra e Trimave" dhe "Tophane", si dhe projekti për ndërtimin e shkollës fillore në lagjen "Arbëria", projekte këto që kanë qenë të parapara të realizohen në vitin 2017?

- Kërkoj që të krijohet një ekip për hetimin e investimeve që janë bërë në shkollën "Hilmi Rakovica" gjatë vitit 2017, për shkak se kanë mbetur punët në gjysmë, të cilat ndoshta rrezikojnë edhe jetën e fëmijëve në atë shkollë, sidomos punët që kanë të bëjnë me rrjetin elektrik.

- Në një pjesë ë të lagjes "Kodra e Trimave", konkretisht pjesa e rrugës që kalon nga ETC-ja deri te Qendra e Panairëve, është krijuar një deponi e mbeturinave të forta nga të gjitha llojet e mbeturinave. Kërkoj që të merren masa në parandalimin e kësaj dukurie.

- Janë dy pjesë të lagjes të cilat nuk kanë ujë 24 orë, është një pjesë në lagjen "Kodrën e Trimave", të cilës i është premtuar një pompë që duhet të vendoset për të pasur 24 orë ujë. Të njëjtin problem për mungesë të një pompe për furnizim me ujë, e kanë edhe banorët e lagjes "Vreshtat".

- Kur do të fillojë të funksionojë Shtëpia e pleqve në lagjen "Tophane"?

- Në shkollën e fshatit Bardhosh nga muaji shtator mungojnë dy mësimdhënës, një për gjuhë zgjedhore dhe një për gjuhë gjermane, që do të thotë se nuk është mbajtur asnjë orë, andaj si do të bëhet notimi i atyre nxënësve?

Për pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës, **Arben Vitia**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe **Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

Agim Gashi, sa i përket projektit për deponinë, theksoi se nuk ka pasur nevojë për kurrfarë plani të ri për këtë fushë, pasi që projekti zbatues për ndërtimin e deponisë për mbeturina nga konstruksioni dhe demolimi, ekziston tash e pesë vjet në Komunën e Prishtinës.

Sami Boroci, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Cilët hapa konkretë janë ndërmarrë, ose planifikohen të ndërmerren në parandalimin e taksive ilegale ose të kombi-busëve që operojnë në linjat e trafikut urban?
- Në rrugët "Selim Kraja" dhe "Pëllumb Ademaj" në lagjen "Veterniku" ose Hajvalia, poshtë Fshatit Ndërkombëtar, kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e këtyre rrugicave?
- Me çfarë dinamike është duke u zhvilluar procesi për pranimin teknik të objekteve, veçanërisht të ndërtimeve të larta?

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, dhe **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dhanë sqarime të nevojshme.

Arbenita Murseli, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Qytetarët të cilët e shfrytëzojnë rrugën "Vëllezërit Fazliu", kërkojnë që qarkullimi në të tri trasetë e kësaj rruge të bëhet me rotacion, që i bie në orët e mëngjesit kur është vlugu më i madh i qarkullimit të qytetarëve, nga Kodra e Trimave në drejtim të qendrës të shfrytëzohen 2 trase, kurse në orët e pasdites të kthehet ashtu siç është tash për tash, 2 trase në drejtim të Kodrës së Trimave, për shkak të fluksit të madh të automjeteve.
- Kërkoj që të merret iniciativë për rregullimin e rrugës, që do ta mundësonte qarkullimin sa më të lirë të qytetarëve nga fshati Ballaban – Nishec, më konkretisht nga Kujevit deri tek shtëpia e ish- Shtabit të UÇK-së, rrugë e cila është plotësisht e degraduar.

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Banorët e lagjes "Përroi i Njelmët" kanë shprehur shqetësim për mungesën e shërbimeve publike në rrethin ku jetojnë, si shkolla, ambulanca, kopshti i fëmijëve. Ata detyrohen që këto shërbime t'i kryejnë në qytet, mirëpo infrastruktura rrugore në atë pjesë është shumë e dëmtuar, rruga ka shumë gropa të mëdha dhe paraqesin rrezik për njerëz dhe për vetura.
- Hapësirat tek varrezat e qytetit, konkretisht hapësira e re e ndërtuar që lidhë lagjen "Arbëria" me lagjen "Kodrën e Trimave", fatkeqësisht ajo hapësirë po shfrytëzohet si deponi.
- A ka ndonjë plan për t'u gjelbëruar kjo pjesë me pisha ose me drurë, e që do ta bënte mbajtjen e dheut për të mos rrëshqitur?
- Kërkesa tjetër është nga banorët tek xhamia e lagjes "Arbëria", ku është një hapësirë e madhe e mbuluar me shkurre, por fatkeqësisht edhe ajo e mbuluar me mbeturina.

Me sa e dimë, ajo është pronë publike e Komunës.

A është e planifikuar që në atë pjesë të ndërtohet një këndë i lojërave apo një park i vogël?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investime Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme lidhur me kërkesat e z. Sopa.

Milazim Vitija, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkoj nga drejtoria përkatëse që kompanitë të cilat janë kompetente për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimrit, që të jenë më të përgjegjshëm në nivel të detyrës, pasi që si pasojë e reshjeve të borës pothuajse të gjitha rrugët e gollakut janë të mbyllura.

Lidhur me kërkesën e z. Vitija, **Brahim Mehmetaj**, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, dha sqarime të nevojshme.

Migjen Shala, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe për nënkryetarin e Komunës së Prishtinës:

- Pse nuk barten me kompensim nxënësit e fshatit Trudë për në shkollën “Anton Zako Çajupi”, kurse relacionet më të shkurtra kompensohen nga Komuna e Prishtinës?

- Pse nuk mund ta bëjnë praktikën në shkollat fillore të komunës së Prishtinës studentët që studiojnë nëpër kolegje private, përveç atyre që studiojnë në kolegjin privat “AAB”?

- Pse Komuna e Prishtinës nuk i financon Organizatat e Dala nga Lufta që veprojnë në komunën e Prishtinës as me mjete logjistike, as me mjete financiare, pra është vetëm Komuna e Prishtinës që dallon prej komunave të tjera?

Lidhur me pyetjet e z. Shala, **Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, dhe **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës, dhanë sqarime të nevojshme.

Sokol Havolli, për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave:

- Kërkoj nga kjo drejtori një njoftim lidhur me të gjitha lëndët që ishin në proces gjyqësor nga ai raporti i cili u diskutua në mbledhjen paraprahe. Është shumë e rëndësishme që të sillen detajet e të gjitha atyre lëndëve gjyqësore dhe ta shohim se pse po humbin ato mjete financiare të Komunës.

- Duhet ta kemi një raport të detajizuar të Trafikut Urban, ta shohim gjendjen financiare të kësaj kompanie, të kemi edhe sqarime të nevojshme se si do të bëhet pagesa e kredisë, që nuk është kredi e vogël për kapacitetin e buxhetit komunal të Prishtinës.

E rëndësishme do të ishte që t'i kemi edhe raportet financiare të kompanive të tjera publike, si dhe një raport në lidhje me lëndët gjyqësore në të cilat Komuna e Prishtinës po humbën shumë mjete financiare dhe të identifikohet shkaktari. Nëse është administrimi i proceseve nga Komuna, apo nëse ka konteste normale gjyqësore sikur me prona apo me diçka tjetër, ato janë në rregull, mirëpo nëse këto ngjarje ndodhin si pasojë e neglizhencës së zyrtarëve komunalë, atëherë ne këto edhe do t'i ngremë si kallëzime penale, në mënyrë që mos të lejojmë dëmtimin e buxhetit publik.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga z. Havolli, **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dha sqarime të nevojshme.

Adrian Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe nënkryetarin e Komunës së Prishtinës:

- Si është e mundur që një kompanie me iu dhënë leja për të bërë promovim në shesh të qytetit, kurse një kompanisë tjetër jo, d.m.th. ka qenë Kompania "FLOW" kompani vendore, e cila ka pasur të bëjë promovim të produkteve të veta, asaj nuk po i jepet leja, kurse një kompanisë tjetër po?
- Kompania "NIKE", brend botëror, ka planifikuar të vendosë nga një kuti të madhe në të gjitha kryeqytetet e botës, d.m.th. i vetmi kryeqytet që e ka refuzuar këtë kërkesë ka qenë Prishtina. Nga kjo është në rrezik edhe kompania e cila e ka përfaqësinë e brendit "NIKE", me humbur përfaqësinë që e ka për Kosovë.
- Sugjeroj që të vendosen dy shtylla antiparking mbi Kurriz, sepse automjetet po hyjnë deri lartë në plato.
- Restorant "Nazi" po i hedh mbeturinat në vend jo adekuate, për të cilën po ankohen sidomos banorët, për shkak të grumbullimit të qenve endacakë, si dhe shfaqjes së insekteve si pasojë e hedhjes së tepërt të produkteve ushqimore.
- Studentët të cilët mësojnë në bibliotekën "Hivzi Sylejmani", kërkojnë që objekti bunker që është afër shkollës fillore "Ismail Qemali", i cili shfrytëzohet vetëm për vendosjen e pajisjeve të punës së ndërmarrjes "Hortikultura", mundësisht ky objekt të shfrytëzohet si sallë leximi për studentë, sepse objekti i bibliotekës është i ngarkuar së tepërmi.
- Është një kërkesë e artistëve që oxhaku i ngrohtores "Termokos", meqë ai tash është jashtë përdorimit, të shndërrohet në një vepër artistike. Për këtë çështje desha të dijë se ku të drejtohem për këtë informacion.
- Sugjeroj që në qytet të ketë më shumë WC publike, sidomos në sheshet dhe në lagje të ndryshme.

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, dhe **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, lidhur me pyetjet e z. Berisha dhanë sqarime të nevojshme.

Mustafë Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Një segment i rrugës për Grashticë, konkretisht rruga që lidh disa lagje të Grashticës së Epërme, është në gjendje shumë të keqe, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, sepse aty ka shembje të dheut. Janë mbyllur kanalet të cilat shërbejnë për largimin e ujërave dhe të gjithë ato ujëra tash rrjedhin në sipërfaqe të asfaltit, prandaj edhe është dëmtuar në masë të madhe. Përpos kësaj, edhe ajo rrugë apo grykë e asaj rrugës është shndërruar në deponi inerte, ku hedhen sasi shumë të mëdha të mbeturinave, prej qytetit drejtohen pikërisht në atë segment rrugor.
- Kërkoj marrjen e masave për këtë, sepse më pak i kushton buxhetit të Komunës që të mirëmbahet ajo rrugë, sesa nesër të trajtohet e tëra apo t' i jepet një shtresë e re e asfaltit.

Shefki Gashi kërkoi nga kryesuesi që mos të lejohet të bëhet propagandë në Kuvend, se ato banesa për të cilat po flitet se janë të uzurpuara, ato nuk janë të uzurpuara, por i ka dhënë ky Kuvend, nga një komision i caktuar.

Njëherësh kërkoi nga kryesuesi, meqë LVV është ndarë në dy grupe, si GP më i madh në Kuvend mbetet LDK-ja, andaj kërkoi që të bëhet riradhitja e ulëseve të subjekteve politike në asamble, për ta ditur se cili grup i Kuvendit është më i madh, e që e ka vendin atje, e grupi më i vogël e ka këndeje.

Kryesuesi tha se sa i përket riradhitjes së ulëseve të subjekteve politike, do të mblidhemi me grupet parlamentare dhe do ta diskutojmë këtë çështje.

Rifat Deri, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, nënkryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejtorisë së Administratës:

- Kur do të fillojë punën ndërmarrja publike "Prishtina Parking" dhe a është kryer zoonimi i plotë i qytetit që ndërlidhet me tarifën e pagesave për parking?
- A është zgjidhur dhe nëse po, si është zgjidhur çështja e parkimit të veturave për banorët e zonave që preken nga kjo ndërmarrje publike?
- Kur do të fillojë ndërtimi i parkingut para Fakultetit të Filologjisë, për të cilin unë jam kategorikisht kundër, dhe a është e zgjidhur çështja e definimit të parkingjeve nëpër zonat publike që aktualisht menaxhohen nga persona fizikë apo kompanitë private?
- Kur do të fillojë ndërtimi i një intineratori, i cili bën djegien e kontrolluar të mbetjeve shtazore dhe medicinale?
- Kur do të fillojnë zgjedhjet lokale në bashkësitë lokale të komunës së Prishtinës?

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Deri, **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim e Kontratave, **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës dhe **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhanë sqarime të nevojshme.

Agim Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Sa shkolla të Prishtinës janë duke i përgatitur nxënësit për testin PISA?
- Pse nuk dërgohen zëvendësimet me kohë, kur mësimdhënëset shkojnë në pushim të lehonisë ose kur marrin pushim mjekësor, dhe a është marrë masë konkrete që ajo punë të sanohet dhe të mos humbin orë mësimore si rezultat i pushimeve mjekësore dhe pushimeve të lehonisë?
- Pse kompanitë mirëmbajtëse dimërore të rrugëve nuk i pastrojnë rrugët e komunës së Prishtinës, që do të thotë nuk i pastrojnë kanalet, nuk i pastrojnë gypat, nuk e heqin dheun dhe gurët me kohë, në mënyrë të shpejtë, por lejojnë dëmtimin e rrugëve për të cilat patëm shumë pyetje këtu?

- Pse kompania "Pastrimi" nuk e bën grumbullimin e mbeturinave në shumë vendbanime të komunës së Prishtinës, kur dihet se në një farë kohe u rregullua disi mirëmbajtja prej fshatit Grashticë-Slivovë-Llabjan dhe tani është ndërprerë?

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Gashi për testin PISA, **Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, dha sqarime të nevojshme.

Fiknete Bejta, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Banorët e Lagjes së Spitalit, afër objektit të EULEX-it, kërkojnë që rruga "Hollgen Petersen" të sanohet, pasi që ajo është e dëmtuar, ka gropa, nuk ka trotuar dhe ndriçimi është i kryer pjesërisht.
- Në kompetencë të kujt është mirëmbajtja e shkallëve te Posta kryesore, pasi që ato janë në gjendje të mjerueshme?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruar nga znj. Bejta.

Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Drejtori i Drejtorisë së Pronës, në mbledhjen e kaluar na informoi se do të mbahet një takim me përfaqësuesit e Komunës dhe përfaqësuesit e KEDS-it apo KEK-ut. Ne nuk kemi asnjë informatë se është mbajtur ky takim apo jo, andaj kërkoj nga drejtori që të na japë një informacion rreth atij takimi.
- Në fshatin Rimanisht ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqen e tokës. Kërkoj nga organet kompetente të ndërmarrin masa paraprake që të sanohet ajo vijë me ujëra të zeza.
- Në pjesët e vendbanimeve Besi, Rimanishtë dhe Vranidoll, në masë të madhe po shkatërrohen pyjet, andaj kërkoj nga drejtoria përkatës që të marrë masa për parandalimin e kësaj dukurie.

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, dhe **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, dhanë sqarime të nevojshme lidhur me pyetjet e parashtruara nga znj. Osmani.

Valbona Ajeti, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit:

- Nxënësit të cilët banojnë afër shkollën fillore "Shkolla e Gjelbër" në Prishtinë mbeten pa u regjistruar në atë shkollë, për shkak se aty vijnë nxënësit nga lagjet tjera dhe regjistrohen, me arsyetimi kinse banojnë aty afër shkollës.
- A do të marrë masa Drejtoria lidhur me këtë çështje?

Sami Salihu, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

Banorët e lagjes “Përroi i Njelmët,” ku ekziston një hekurudhë e trenit në mes të rrugës e cila e lidh Zonën industriale me lagjen “Përroi i Njelmët”, e që iu rrezikohet jeta këtyre qytetarëve dhe nxënësve, pasi që detyrohen ta kalojnë atë hekurudhë, e aty nuk janë të vendosura pengesat (rampat) dhe shenjat sinjalizuese për hekurudhë. Është kërkesë e qytetarëve që të vendosen shenjat sinjalizuese dhe pengesat që të sigurohet jeta e qytetarëve.

Edhe në lagjen “Dardania” ekziston një burim i ujit, i cili quhet Kroj i Bardhë, e që është në gjendje të mjerueshme nga papastërtia dhe është jo funksional.

Nga kjo gjendje jo e pastër mund të përhapet epidemi, prandaj kërkojmë që të bëhet pastrimi i këtij kroj dhe të funksionalizohet.

Genc Sherifi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e rrugës “Agim Ramadani” dhe ndërtimi i shkollës në lagjen “Mati 1”?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Sherifi.

Halim Halimi, për kryesuesin e Kuvendit:

- Kërkoj nga kryesuesi i Kuvendit që të gjitha vendimet të cilat vijnë nga Ministria e Pushtetit Lokal, nga një kopje t’u dërgohet anëtarëve të Kuvendit, në mënyrë që të dimë se vendimet tona a kanë qenë të ligjshme apo të paligjshme.

Kryesuesi tha se këtë kërkesë do ta marrë për obligim dhe vendimet që kthehen nga MAPL – ja do t’u dërgohen anëtarëve të Kuvendit.

Besnik Mujeci, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Memenaxhimit të Kontratave:

Tri rrugët që e lidhin lagjen “Mati” me Taukbahçen, janë tri rrugë në gjendje shumë të mjerueshme: “Kushtrim Hoxha”, “Andrea Varfi” dhe “Rruga e Komonit”.

- Komuna e Prishtinës a e ka në plan t’i shtrojë këto rrugë me asfalt apo me kubza?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Mujeci dha sqarime të nevojshme.

Vjosa Hamiti - Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Banorët e lagjes afër rrugës "Ndue Përlleshi" kërkojnë të dinë se rruga e cila është e shtruar në kubza, por që është e shkatërruar plotësisht, a planifikohet që gjatë këtij viti, apo gjatë këtij mandati të bëhet sanimi i saj?

Gëzim Mehmeti drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Krasniqi.

Eman Rrahmani, për Komisionin për emërtimin e rrugëve:

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës ka propozuar më herët që një rrugës në Prishtinë t'i vihet emri Ramadan Rexha, i dënuar politik me 15 vjet burg, ka qenë propozim por nuk është vendos ky emër.

- A është ende në funksion Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe pse nuk është emërtuar asnjë rrugë me emrin e të propozuarit Ramadan Rexha?

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, në emër të ish- anëtarit të komisionit paraprak në legjislacionin e kaluar, për pyetjen e parashtruar nga z. Rrahmani dha sqarime të nevojshme.

Sami Borovci, për kryesuesin e Kuvendit:

- Si mund të iniciohet procedura për formimin e një komisioni për t'i trajtuar edhe një herë ankesat për disa rrugë në Prishtinë?

Kryesuesi tha se sa i përket çështjes së emërtimit të rrugëve, mund të kontaktoni me Zyrën ligjore.

Rifat Deri, para të pranishmëve ngriti shqetësimet e një numri të konsiderueshëm të qytetarëve lidhur me emërtimin e disa rrugëve me emrat e disa personaliteteve që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare. Lidhur me këtë, ceku se me rasatin e emërimit të rrugëve në kryeqendrën tonë, janë bërë hile dhe padrejtësi, është punuar jo profesionalisht. Kështu është punuar jo vetëm viteve të fundit, sepse për një kohë të gjatë nuk është punuar drejt, ngase nuk është dëgjuar zëri i qytetarëve tanë që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Komisioni i cili i ka anashkaluar emrat e personaliteteve që kanë dhënë kontribut për çështjen kombëtare, duhet të mbajë përgjegjësi.

Shefki Gashi, ish- anëtar i Komisionit për emërtimin e rrugëve, tha se Komisioni për emërtimin e rrugëve ka punuar në mënyrën sa më transparente. Fillimisht i kemi informuar mjetet e informimit në Kuvend, po ashtu nga Bashkësitë lokale kemi kërkuar që të na i sjellin listat me emrat e propozuar. Sa i përket Komisionit për emërtimin e rrugëve, kjo legjislaturë atij komisioni duhet verifikuar mandatin.

Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

Qytetarët afër rrugës “Bedri Shala” ankohen në punën, mbikëqyrjen e së cilës e bëjnë organet e Komunës, konkretisht në punën e inspektorëve, duke u ankuar se një inspektor dyshohet se është i afërm i pronarit të kompanisë “Pozhegu Bradhers”, e cila tash e sa kohë bën bllokimin e rrugës me automjetet për shkarkimin e betonit, të cilat vendosen në rrugë gjatë ndërtimeve që janë duke u bërë në atë pjesë.

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, për shqetësimet e ngritura nga z. Rrahmani dha sqarime të nevojshme.

Haki Dragusha, për ekzekutivin:

- Më 8 mars 2018, në fshatin Bërnice e Epërme ka pasur një fatkeqësi natyrore, ku një erë e madhe i ka hequr kulmin një punëtorie. Nuk e di a ka dalë dikush me e verifikuar gjendjen. Pronari i kësaj punëtorie e ka pushuar veprimtarinë, sepse nuk e kanë gjendjen e mirë ekonomike, andaj do të duhej të ndihmohej.

- Te çerdhja në lagjen “Dardania” është hapur një punëtorie – servis i internetit dhe e ka bllokuar parkingun para çerdhes, i cili shfrytëzohet nga banorët dhe nga qytetarët që sjellin fëmijët në çerdhe.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga z. Dragusha, **Brahim Mehmetaj**, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, dhe **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, dhanë sqarime të nevojshme.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se 9 anëtarë të Kuvendit tani funksionojnë si Grup i pavarur. Anëtarë të këtij grupi janë: Nol Nushi, Genc Sherifi, Vala Peshku, Visare Gorani-Gashi, Bashkim Beha, Adrian Berisha, Qëndrim Sahiti, Mimoza Sylejmani dhe Drilon Pireva.

Shefe e këtij grupi të pavarur është caktuar znj. Vala Peshku.

Valbona Petrovci i njoftoi të pranishmit se tani e tutje do të veprojë si asambliste e pavarur.

Halim Halimi kërkoi që renditja e ulëseve të subjekteve politike në Kuvendin e Komunës të bëhet ashtu siç është praktikë, d.m.th. grupi më i madh parlamentar të dalë në vendet ku ka qenë LVV-ja.

Ai kërkoi që kjo çështje për mbledhjen e radhës të rregullohet.

Pika e tretë

Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së “Kodra e Trimave 1”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, tha se vendimi që është marrë për këtë plan rregullues në këtë kuvend, në vitin 2017, ka qenë i kundërligjshëm, andaj qytetarët e lagjes "Kodra e Trimave" duan vendim të ligjshëm, duan vendim të bazuar në Hartën zonale, e jo një Plan rregullues të kundërligjshëm. Prandaj edhe ka paqartësi të mëdha, kështu që vështirë është me u zbatuar ai Plan rregullues.

Për vërejtjet e dhëna nga z. Halimi, **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, dha sqarime të nevojshme.

Vala Peshku, në emër të GP të pavarur, u shpreh në përkrahje të këtij vendimi.

Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendim, por sugjeroi që nëse Ministria brenda 15 ditëve nuk e kthen përgjigjen, përsëri mundeni me iu drejtuar, por nëse e kthen përgjigjen se vendimi është i kundërligjshëm, atëherë ne do të dalim në lajthitje.

Valbona Ajeti, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratim e propozimvendimit.

Vesel Makolli, në emër të GP AKR-AA, e përkrahu miratimin e vendimit, por me një vërejtje, sepse është dashtë që përkufizimi, skemat e asaj pjese të jenë më të qarta.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 1 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për përmirësimin e gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së "Kodra e Trimave 1".

Pika e katërt, e pestë dhe e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi; Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha dhe Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, tha se i përkrahim këto propozimvendime për këmbim, me vërejtje që në rastet e tilla të mos bëhet seleksionim, dikujt t'i mundësohet këmbimi e dikujt jo, por të jemi të barabartë për të gjithë.

Vala Peshku, në emër të GP të pavarur, tha se këto propozimvendime i përkrahim për miratim, por kërkojmë që z. Dren Kukaj herën tjetër të jetë më i përgatitur dhe të dalë me përgjigje sa më të sakta.

Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe ne i përkrahim për miratim këto propozimvendime, por kërkojmë nga drejtori Dren Kukaj, që të na e paraqet një arsyeshmëri më të zgjeruar rreth kritereve që e përcaktojnë në mënyrë më koncize këmbimin e pronave.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, tha se këto tri pika për këmbimin e pronave për ne janë të papranueshme, dhe nëse i votojmë, atëherë po qesim precedent të keq për këtë asamble, pavarësisht kësaj situate dhe praktikave që i kemi pasur më herët.

Yll Bogaj, në emër të GP të AAK-së, tha se këto këmbime i përkrahim për miratim.

Vesel Makolli, në emër të GP të AKR -AA, tha se edhe ne i përkrahim, por sugjerojmë që në raste të tilla, këmbimi i pronave të bëhet në bazë të vlerës së tokës dhe të mendohet në interesin e Komunes, pra interesin e përgjithshëm në rend të parë.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimvendimet për këmbimin e pronave.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi.

Pika e shtatë e rendit të ditës

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Osman Bllaca në emër të ekzekutivit, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth Propozimvendimit për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo rregullore është punuar në bazë të një vendimi dhe mendoj se është punuar mirë, por vërejtja ime është që te subvencionet e Kryetarit duhet të jetë një shumë e limituar.

Vala Peshku, në emër të GP të pavarur, propozoi që në këtë rregullore të parashihet mundësia e subvencionimit t[ë]e disa raste, konkretisht te kategoria e nënave vetushqyese.

Egzon Azemi, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe ne parimisht e përkrahim këtë rregullore për miratim, por me një vërejtje që subvencionet e Kryetarit duhet të jenë të kufizuar, sepse kjo shumë lehtë mund të shërbejë vetëm për interesa të ngushta të tij.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë rregullore për miratim, duke pasur parasysh faktin se kjo rregullore ka paraparë edhe subvencione në bujqësi.

Valbona Ajeti, në emër të GP të AAK-së, edhe grupi ynë pajtohet për miratimin e kësaj rregulloreje, duke pasur parasysh formimin e komisioneve nga drejtoritë përkatëse. Besoj se kjo ka ndikuar që të merret si gjykim i drejtë dhe të jetë transparente ndarja e atyre mjeteve familjeve me nevojë.

Rifat Deri, në emër të GP AKR-AA, tha se ne për këtë rregullore kemi disa vërejtje, si p.sh. në nenin 6, paragrafi 6.2; në nenin 9; në nenin 14, pikat h, e, ë; në nenin 15, pika 15.3; në neni 16, pika 16.2, nënpikat i, j, k). Për nenin 16, propozoj që t'i shtohet edhe një nënpikë (ë). Po ashtu, vërejte në pikën 16.4, në nenin 17, respektivisht pika 17.1 dhe nënpikën b. Vërejtje në nenin 20, pikat d, e, f, në nenin 22, pika 22.7, në nenin 23, pika b, në nenin 25, vërejtje po ashtu edhe për nenin 29. Ai kërkoi që të bëhet korrigjimi dhe plotësimi i këtyre neneve.

Fiknete Bejta tha se kjo propozimrregullore ka mangësi në përkufizimin e qartë të termit subvencion, në përcaktimin e kritereve për subvencion, shuma e komisionit vlerësues etj. Po ashtu, në këtë propozimrregullore mund të konstatoj se nuk janë respektuar 4 elementet bazë, pagesa ndaj kujt duhet të bëhet, mënyra e pagesës, e cila është saktësuar vetëm pjesërisht, qëllimi apo arsyeshmëria e pagesës, si dhe kufizimi me pagesë brenda një viti fiskal etj.

Sokol Havolli sugjeroi që shuma e propozuar nga kryetari mbi 10.000 €, t'i nënshtrohet edhe votimit në Kuvend. Kjo e rritur transparencën, sepse transparenca është njëra prej elementeve kyçe sa i përket ndarjes së subvencioneve. Do të duhej që në rast të subvencionimit në fusha të ndryshme, të kihet parasysh shmangia e konfliktit të interesit.

Kushtrim Sopa tha se qëllimi apo planifikimi i ndarjes së këtyre subvencioneve, nënkuptohet se është i mirë dhe motivues i madh për përfituesit eventual.

Do të dëshiroja që para nesh ta kishim edhe planifikimin financiar për ndarjen e subvencioneve për secilën fushë, secilin sektorë, dhe besoj do të ishte shumë më e qartë se a do të bëhet në mënyrën e duhur planifikimi dhe a plotëson nevojat e fushave.

Agim Gashi tha se Kryetari e ka të drejtën ekskluzive për ndarje të subvencioneve në shumën deri në 10,000 €, dhe se kjo është e paraparë me ligj, por duhet të kihet parasysh se subvencionet janë të destinuara për qytetarët rezidentë të komunës së Prishtinës, si dhe në situata të ndryshme t'i ikën konfliktit të interesit.

Arbenita Murseli tha se këto subvencione janë të mirëseardhura për secilën fushë, qoftë në fushën e arsimit, të bujqësisë etj. që janë cekur në këtë rregullore, por duke u plotësuar disa kritere, subvencione këto të cilat do t'i kontribuojnë zhvillimit ekonomik të Prishtinës. Po ashtu, komisionet e përzgjedhura për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të na raportojnë në vazhdimësi, si dhe të kemi edhe një raport të qartë rreth monitorimit të shfrytëzimit të këtyre subvencioneve.

Adrian Berisha vërejte bëri në nenin 6, pika 2, "Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna". Unë nuk pajtohem me këtë pikë, sepse çka nëse një organizatë i ka tri projekte shumë të mira, kurse përfitues është një organizatë tjetër, e cila e ka një projekt jo të mirë. Vërejtje pati edhe rreth procedurës që ka të bëjë me aplikimin e bursave, e që është dashtë të parashihen edhe dokumente të tjera, si ato të trajnimit ose dokumente të vullnetarizmit. Ai sugjeroi që në kompensimin për shpenzimet e varrimit, përparësi të kenë familjet me gjendje të rëndë sociale dhe familjet e dëmtuara nga lufta.

Naime Osmani kërkoi që në rast subvencionit, të shihet mundësia e përkrahjes, sidomos e grave në bizneset e vogla, por të përkrahen edhe zonat rurale.

Vala Peshku shprehu mospajtime lidhur me disa vërejtje që i dha z. Deri. Disa nga ato nene janë të qarta, se në këto pika në qartësi thuhet se këto biznese nuk guxojnë të kenë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

Suzan Kika theksoi se tek subvencionet për bujqit politikat e subvencioneve duhet ndryshuar në favor të lehtësive sa i përket përgatitjeve të dokumentacioneve, sidomos për fushën e bujqësisë, në mënyrë që mos t'ua marrim kohën e çmuar të punës, të mos krijojmë tollovi para zyrave pritëse për aplikuesit.

Nol Nushi kryesisht u përqendrua në nenin 14, që ka të bëjë me subvencionet në arsim, ku një ndër pikat janë bursat për studentë. Po ashtu, në nenin 15, ku parashihet kriteri i gjendjes ekonomike, duhet me qenë pothuajse i njëjtë me atë të notës mesatare. Do të ishte mirë që me e pasur parasysh aftësinë e kufizuar të studentit.

Valbona Petrovci, bëri vërejte në nenin 24, pika (e), ku bëhet fjalë për subvencionimin e manifestimeve. Ajo sugjeroi që personave fizikë të mos iu mundësohet aplikimi për organizim të manifestimeve kombëtare, atyre që janë të karakterit kombëtar dhe që kanë shpenzime enorme.

Egzon Azemi tha se ajo që është e rëndësishme, që duhet marrë shumë parasysh, përveç dhënies së subvencioneve, këtu duhet të jetë një fokus i veçantë i Komunës edhe në monitorimin e tyre.

Fiknete Bejta tha se duhet dalluar subvencionimin prej konkursit. Nëse kemi konkurs, atëherë mund të fitojë 10 herë dikush me një krijimtari, por këtu e kemi fjalë për subvencionim, ku bazohet në kriteret e barabarta, d.m.th. duhet me qenë të barabartë.

Eman Rrahmani propozoi që nenit 16, pika 16.3, t'i shtohet edhe: "Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në komunën e Prishtinës dhe që janë banorë të Prishtinës".

Pas diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në vitin propozimregulloren.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK -së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Vala Peshku në emër të GP të pavarur, në parim u shpreh në përkrahje, por me një vërejte te neni 24, të parashihet si pikë shtesë: "vendosja e kutive në secilin prej bizneseve, për vërejtjet e punëtorëve të atij biznesi, për respektimin e orarit të punës, kontratave të punës, pagesave etj.

Vjosa Hamiti-Krasniqi, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe në parim e përkrahim miratimin e proozimrregullores.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, tha se në parim edhe ne e përkrahim, por do te ishte mirë që të parashihej një pauzë edhe te punëtorët që punojnë në ndërtimtari.

Valbona Ajeti, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratimin e rregullores.

Sami Borovci, në emër të GP të AKR-AA-së, u shpreh në përkrahje të propozimrregullores, por kërkoi që gjatë diskutimit publik të përfshihen edhe grupet e interesit që afektojnë në këtë rregullore dhe jo me pasur ndoshta vetëm diskutim sipërfaqësor.

Adrian Berisha theksoi se do të duhej ftuar të gjitha palët e interesit në diskutimit publik, d.m.th. me e gjetur mënyrën më të mirë që me qenë të pranishëm të gjithë, p.sh. Shoqata e Gastronomëve të Prishtinës, Shoqata e Ndërtimtarëve të Prishtinës etj.

Sokol Havolli theksoi se përveç konsultimeve intensive me Shoqatën e Gastronomëve etj. besoj se edhe disa prej nesh në momentin që kishim me qenë të njoftuar me marrë pjesë në diskutime, do të kishim dhënë kontribut në këtë drejtim. Ai sugjeroi që të tregohet kujdes i shtuar me orarin e kafeterive.

Arbenita Murseli theksoi se këto rregulla duhet të vlejnjë për të gjithë njësoj, mos të ketë privilegje vetëm për një pjesë të caktuar, e pjesa tjetër të ketë ndëshkime. Ai kërkoi që Ligji i punës të vihet në pah dhe të ketë përpikëri të zbatimit.

Shefqet Osmani bëri vërejtje në nenin 9, dhe propozoi që këtij nenin t'i shtohet edhe fraza: "... industria prodhuese, sidomos e cila do të vinte në shprehje gjatë sezonit të verës, ku ka nevojë të punohet në tri ndërresa".

Suzan Kika bëri vërejtje lidhur me kohëzgjatjen e punës për shoqëritë tregtare, hotelëritë në brendi të qytetit, ku përveç se janë parë kritere ku janë të hapura lokalet, nuk është menduar edhe aq shumë as kriteri i kohëzgjatjes së punës në hapësirën e banimit. Ajo kërkoi që nga e hëna në të premtën, orari i punës të kufizohet deri në orën 22:00. Njëherësh propozoi që të kufizohet koha për furnizimin e bizneseve.

Egzon Azemi kërkoi të dijë se si do të bëhet organizimi i këtij debati publik dhe në çfarë mënyre do të ftohen palët e interesuara.

Osman Bllaca, përfaqësuesi ekzekutiv, lidhur me mënyrën organizimit të debatit publik dha sqarime të nevojshme.

Leutrim Retkoceri propozoi që me rasatin e grumbullimit të mbeturinave të caktohet një orar, pra të jetë pas orës 24.

Drilon Pireva theksoi se te kriteret për punën e caktimit të orarit, do të duhej pasur parasysh edhe vendin se ku ndodhet veprimtaria dhe koha.

Naime Osmani sugjeroi që te fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të pylltarisë, për prerjen e druve, periudha verore të jetë nga ora 8:00-20:00, periudha dimërore nga ora 8:00-18:00.

Nol Nushi tha se shumë nga diskutimet e parafolësve nuk qëndrojnë, andaj ne duhet të fokusohemi vetëm në orarin e punës së bizneseve të ndryshme.

Rifat Deri bëri vërejte në nenin 20.3, rreth zgjatjes së orarit të punës, se kemi zgjatje të tepërt të orarit për disa sektorë, por duhet gjetur ndonjë modus pak më të lehtë, për të mos i ngarkuar aq shumë.

Pas diskutimeve **kryesuesi** e hodhi në votim propozimrregulloren.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim, u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në pika te shkurtër i informoi të pranishmit lidhur me Propozimvendimin për konsulta paraprake publike të Rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, tha se këtë propozimrregullore e përkrahim për miratim.

Vjosa Hamiti-Krasniqi, në emër të GP të LVV-së, e përkrahu për miratim këtë propozimrregullore.

Vala Peshku, në emër të GP të pavarur, u shpreh në përkrahje të miratimit të propozimrregulloes.

Florida Canolli, në emër të GP të PDK-së, theksoi se e përkrahim për miratim këtë propozimrregullore.

Valbona Ajeti, në emër të GP AAK-së, e përkrahu miratimin e propozimrregullores.

Vesel Makolli, në emër të GP të AKR-AA-së, theksoi se e përkrahim për miratimin e propozimrregulloen.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimrregulloren.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Pika e dhjetë

Diskutim për sheshin “Adem Jashari”.

Kryesuesi: Hapi diskutimin.

Halim Halimi në emër të GP të LDK-së, tha se duke e pas parasysh që nuk është i pranishëm drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe nuk jemi as të përgatitur, ne jemi për rregullimin e këtij sheshi dhe vendosjen e shtatores së Adem Jasharit.

Kryesuesi tha se duke pasur parasysh që kjo pikë u kërkua të futet në rend të ditës, propozoj që ta procedojmë për diskutim.

Migjen Shala, në emër të GP të PDK-së, tha se ne si grup mendojmë që ky shesh është i vogël për t’u quajtur sheshi “Adem Jashari”. Si mundet me u quajtur ky sheshi “Adem Jashari”, kur aty është një monument prej hekuri dhe betonit, që simbolizon bashkim-vëllazërimin e ish-komunizmit! Ne mendojmë që janë dy rrugë këtu, ose t’i hiqet këtij sheshi emri “Adem Jashari” e të rivendoset diku tjetër, ose të rrëzohet ai monument.

Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Shala dha sqarime të nevojshme.

Egzon Azemi tha se është më se e rëndësishme që sa më parë të ndërtohet shtatorja e Komandantit Legjendar, Adem Jashari. Personalisht mendoj që është mirë pikërisht këtu me u ndërtuar, jo për shkak që është ajo përmendore, po pikërisht se është një ndër pjesët më të rëndësishme të kryeqytetit, është vend me rëndësi të veçantë, është në mes të dy institucioneve, Komunës dhe Kuvendit të Kosovës.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme lidhur me sugjerimet e dhëna nga z. Azemi.

Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se kërkesa e z. Migjen Shala është shumë e qartë, andaj ne e kemi për obligim që ta zbatojmë këtë vendim derisa nuk e ndërrojmë. Aty duhet të vendoset shtatorja e Adem Jasharit. Unë mendoj se duhet rrëzuar atë monument të së kaluarës.

Adrian Berisha propozoi që Kuvendi i Komunës të marrë vendim për gjetjen e një lokacioni tjetër dhe të emërtohet sheshi “Adem Jashari”.

Besoj se kemi mundësi të gjejmë lokacion tjetër dhe të emërtohet sheshi “Adem Jashari”. Jam kundër rrënimit ose zhvendosjes së monumentit të lirisë.

Nol Nushi tha se Prishtina ka nevojë për një bust ose një muze, monument i cili përfaqëson shumë mirë vlerat e luftës. Mendoj që si pjesë e një memorialit të UÇK-së në Prishtinë, që kishte me qenë pikë shumë prioritare turistike, do të mund të ishte edhe shtatorja e Adem Jasharit dhe tërë historia e luftës së fundit.

Leutrim Retkoceri tha se ne sot, 20 vite pas rënies së heroit Adem Jashari, fal sakrificës së tij dhe të tjerëve, na mundësohet që të jetojmë e të ëndërrojmë të lirë. Kryeqyteti ynë Prishtina ende nuk ka shtatore të heroit Adem Jashari. Shtatore ka vendosur Tirana, e besa do të vendosë edhe Shkupi, derisa ish-kryetarët dhe kryetari i tanishëm i Prishtinës, fshihen pas arsyeve të kota për mos përmbushjen e këtij obligimi moral e atdhetar. Për shkak të rëndësisë historike të shtatores së Adem Jasharit, nuk meriton ky Kuvend që sot të ndahet në atë se a duhet apo nuk duhet të vendoset shtatorja në shesh. Diskutimi më i mirë dhe më i sqartë do të na bënte nder pikësëpari neve këtu si kolegë asamblastë, pastaj ta përmbushim këtë obligim.

Kryesuesi tha se e ftoj edhe kryetarin e Komunës këtu me qenë, se është çështje e ekzekutivit, pra po i japim një kohë, një distancë kohore ekzekutivit, le ta mendojë mirë këtë çështje, por sheshi nga ky Kuvend është emërtuar sheshi “Adem Jashari”.

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, theksoi se edhe unë jam i mendimit që Adem Jashari nuk mund të jetë në krah të një përmendoreje, e cila është ngritur ndoshta për një bashkim-vëllazërim. Do të ishte mirë që të mendojmë që diku tjetër ta gjejmë lokacionin dhe ta emërtojmë me emrin Adem Jashari, ose ajo përmendore duhet të hiqet përfundimisht, se figura e Adem Jasharit nuk mund ta ketë vendin afër saj.

Sami Borovci tha se nuk pajtohem që ky shesh të quhet sheshi “Adem Jashari”. Prandaj, nëse ka hapësirë ligjore dhe nëse është e mundur, kisha rekomanduar që me iu ndërruar emri këtij sheshi, le të quhet në çfarëdo forme. Besoj shumë se një shtatore e Adem Jasharit duhet patjetër me qenë në Prishtinë.

Besnik Mujeci propozoi që sheshit Adem Jashari t’i ndërrohet vendi, pasi që nuk po dëshirojnë që aty të vendoset shtatorja e tillë dhe të bëhet një shesh me emrin dhe me shtatoren e tij, dhe ky të mbetet si Sheshi i Lirisë dhe të mbetet ajo përmendore nga e kaluara.

Mimoza Sylejmani tha se fatkeqësisht nuk kemi sheshe të mirëfillta, këto nuk janë sheshe, janë mini-sheshe dhe këto monumente duhet të vendosen në vendet më të ngritura nga toka, por në mungesë i kemi futur kështu dhe po i quajmë sheshe, në fakt nuk janë sheshe.

Mustafë Krasniqi tha se pavarësisht që si shesh është emërtuar në vitin 2005 dhe është menduar që mund të jetë adekuat si shesh, që mund të emërtohet me emrin e heroit kombëtar Adem Jashari, gjithsesi duhet të dalë një kërkesë prej anëtarëve të Kuvendit, ose prej kujtdo qoftë prej këtyre që e ngritën çështjen, dhe të merret e të analizohet mirë ku mund të gjendet një shesh adekuat, me përmasa edhe më të mëdha, që do t'i përgjigjej një sheshi me emrin Adem Jashari.

Mbledhja përfundoi në orën 16:55.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta